



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:254158
Datë: 28.02.2024
Numri i dokumentit: 05389986

KPPP.nr.2183/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit RR.H. B.I., me NUI: 811293620, me seli në fshatin Vlashje Komuna e Prizenit, kundër debitorit Galeria Shopping Mall Sh.P.K., me NUI: 810095837 me seli në Çagllavicë - Llapnasellë KM 3, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Zyra e Avokatëve “Hodaj & Partners” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit P.nr.979/2021 të datës 21.09.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Enis Hoxha me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 23.02.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

- I. APROVOHET ne tërësi i bazuar prapësimi i debitorit Galeria Shopping Mall Sh.P.K., ashtu që SHFUQIZOHET Urdhri P.nr.979/2021 i datës 21.09.2021, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Enis Hoxha me seli në Prizren.
- II. Detyrohet kreditori që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj debitorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë në shumë të përgjithshme prej 156 €, në emër të përpilimit të prapësimit nga avokati.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit P.nr.979/2021 të datës 21.09.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave dhe atë: faturës nr.Q-12 të datës 15.12.2020 në vlerë prej 1,000.00 € dhe faturës nr.Q-01_01 të datës 18.01.2021 në vlerë prej 1,000.00 €, duke e obliguar debitorin që t’ia

paguajë kreditorit borxhin në shumën e përgjithshme prej 2,000.00 € dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Kundër Urdhrit të Përmbauesit Privat, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim, në të cilin ka theksuar se faturat për të cilat kreditori pretendon se nuk i janë paguar, debitori nuk i ka pranuar fare, andaj këto fatura konform nenit 27 të LPP-së nuk janë të përshtatshme për përbarim, ngase të njëjtat nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt pasi që iu mungon nënshkrimi dhe vula e debitorit. Tutje ka shtuar se faturat në bazë të së cilave është inicuar procedura përbarimore për të qenë të përshtatshme për përbarim duhet të nënshkruhen dhe të vulosen nga personi kompetent për t'i pranuar faturat, dhe se një gjë e tillë është kërkesë e përcaktuar sipas praktikës gjyqësore dhe atë sipas Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës CML.nr.24/2017 të datës 18.01.2018, e cila kërkesë është paraqitur me qëllim të evitimit të keqpërdorimeve eventuale për realizimin e të drejtave jo ekzistuese përmes procedurës përbarimore. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta anuloj Urdhrin përbarimor, si dhe të detyrohet kreditri t'ia mbulojë të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore konform Tarifës së Odës së Avokatëve, t'ia paguaj shumën prej 312 Euro, në emër të përpilimit të prapësimit.

Kreditori, në përgjigje në prapësim, e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pabazuar, duke theksuar se fatura si dokument i besueshëm përmban të gjitha tiparet e një dokumenti të përmbaueshëm, ndërsa debitori nuk i ka pranuar faturat e fundit me qëllim të mospërmbushjes së pagesës sipas kontratës të cilën e kanë bërë me marrëveshje të dyanshme, andaj mospranimi i faturave në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit nuk mund të llogaritet se debitori nuk i ka borxh kreditorit, sepse me vet faktin e refuzimit të pranimit në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit, janë plotësuar të gjitha kushtet për përbarim sepse është bërë dorëzimi i rregullt i faturës. Gjykatës i ka propozuar që prapësimi të refuzohet si i pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri i Përmbauesit Privat.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PPP.nr.1348/2021 të datës 12.09.2022, e ka aprovuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Galeria Shopping Mall Sh.P.K., dhe e ka shfuqizuar urdhrin përbarimor P.nr.979/2021 të datës 21.09.2021.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.761/23 të datës 20.11.2023 e ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit, dhe sipas detyrës zyrtare e ka anuluar vendimin e shkallës së parë PPP.nr.1348/2021 të datës 12.09.2022, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje. Kjo gjykatë ka vlerësuar se Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë, është kompetente në pikëpamje lëndore, për shkak se nga referati i padisë, rezulton se palët ndërgjyqëse janë shoqëri tregtare dhe me padi pretendohet se në mes tyre janë krijuar marrëdhënie juridiko-detyrimore me karakter afarist.

Gjykata në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura nr.Q-12 e dates 15.12.2020 në vlerë prej 1,000.00 € dhe fatura nr.Q-01-01 e datës 18.01.2021 në vlerë prej 1,000.00 €, në bazë të së cilave është lejuar përmbartimi, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që faturat janë dorëzuar dhe janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, ngase në këto fatura nuk është evidentuar nënshkrimi apo vula e pranimit të debitorit, në mënyrë që debitori të njoftohet me detyrimin që buron nga të njëjtat.

Gjykata vlerëson se meqenëse kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë nga e cila rezulton se pranimi i faturave konkrete është bërë në mënyrë të rregullt nga debitori, atëherë rezulton se faturat e lartcekura nuk mund të paraqesin bazë për lejimin e përmbartimit.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e debitorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të prapësimit, ndërsa lartësinë e saj gjykata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifat e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 par.2 të LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbarimit, numri i palëve të përfaqësuara, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2183/23 me datë 23.02.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.